



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 490/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AKK), dega në Deçan, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në Qendrën e Votimit nr. 0103C në shkollën fillore "Drita" në fshatin Gramaqel, pretendohet se janë kërcënuar dhe shantazhuar vëzhguesit e LDK-së nga militantët e AAK-së. Po ashtu, në dijeni të këtyre kërcënimeve kanë qenë edhe Policia e Kosovës dhe të cilët ishin neglizhentë në marrjen e masave kundër kërcënuesve thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove apo dëshmitar të rastit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *"Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar"*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik LDK nuk qëndrojnë ngase në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur, asnjë provë bindëse apo nuk ka dhënë ndonjë emër të ndonjë dëshmitari të ngjarjes për të cilën pretendohet, që mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 490/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.